



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.110

15 gusht

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MB nr.1245, datë 15.8.2007	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për në Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.31	3189
Vendim i ERE nr.46, datë 10.8.2007	Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe të llogaritjes së dëmit që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike	3190
Vendim i ERE nr.48, datë 14.8.2007	Për miratimin e “Marrëveshjes së interkompensimit të transitimit”	3195
	Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”	3195
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Zenel Zabit Kaferi	3197

UDHËZIM
Nr.1245, datë 15.8.2007

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR NË KUVENDIN E SHQIPËRISË NË ZONËN ZGJEDHORE NR.31**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5453, datë 13.8.2007 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për në Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.31", të nenit 60/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zyra e gjendjes civile në njësinë bashkiake nr.9, Tiranë, ku do të kryhen zgjedhjet e pjesshme për në Kuvendin e Shqipërisë, pas marrjes së listës përfundimtare të zgjedhjeve të datës 18 shkurt 2007, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të kryejë përditësimin e listave të zgjedhësve, për zgjedhjet e datës 23 shtator 2007, jo më vonë se data 25 gusht 2007, sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në të dhënat e regjistrave themeltarë me vendbanim të kësaj njësie.

2. Kryetari i njësisë bashkiake nr.9, pasi merr listën e zgjedhësve nga zyra e gjendjes civile, brenda datës 26 gusht dërgon listat e zgjedhësve të përditësuara në letër dhe një kopje e tyre në format elektronik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile brenda 24 orëve nga marrja e listave të përditësuara i dërgon njësisë përkatëse të qeverisjes vendore listën e dublimeve të dyshuara brenda vetë njësisë së qeverisjes vendore dhe ato me njësi të ndryshme të kësaj zone zgjedhore.

Për dublimet brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i kërkon kryetarit të njësisë bashkiake nr.9, heqjen e zgjedhësit nga lista e zgjedhësve për shkak të ndodhjes më shumë se një herë në listën e zgjedhësve.

4. Kryetari i njësisë bashkiake nr.9, pasi ka marrë vendim për heqjen nga lista e zgjedhësve të zgjedhësve të regjistruar më shumë se një herë, miraton listën përfundimtare të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme të datës 23 shtator 2007, jo më vonë se data 28 gusht 2007.

5. Pas miratimit nga kryetari i njësisë bashkiake nr.9, lista përfundimtare e zgjedhësve i dërgohet KZZ-së me datë 28 gusht 2007, të printuara në tri formate, sipas përcaktimeve të nenit 59 të Kodit Zgjedhor:

- Listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit për t'u shpallur pranë çdo qendre votimi. Një kopje e kësaj liste dhe në format elektronik i dërgohet DPGJC-së brenda 24 orësh;

- Listë zgjedhësish në nivel të njësisë së qeverisjes vendore që mbahet nga KZZ-ja për informimin e zgjedhësve, e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrit të zgjedhësve;

- Listë zgjedhësish e ndarë sipas qendrave të votimit, e cila i dorëzohet KZZ-së për t'u përdorur nga KQV-ja ditën e votimit. Kjo listë duhet të përmbajë për çdo zgjedhës edhe emërtimin, numrin dhe faqen e regjistratit themeltar me vendbanim të gjendjes civile të njësisë përkatëse.

6. Brenda 24 orëve nga marrja e listave përfundimtare, KZZ-ja i shpall ato pranë qendrave përkatëse të votimit në një vend me hyrje të lirë.

7. Kryetari i njësisë bashkiake nr.9, pas miratimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, jo më vonë se data 13 shtator 2007, kryen njoftimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në listat përfundimtare, me anë të grupeve dyshe të punës të ngritura për çdo qendër votimi, sipas kësaj procedure:

- Njoftimi me shkrim i zgjedhësve kryhet nga grupet dyshe të punës, të formuara nga një përfaqësues i administratës së bashkisë dhe një përfaqësues i caktuar nga partia më e madhe në opozitë me kryetarin e njësisë bashkiake nr.9;

- Jo më vonë se data 30 gusht 2007 kryetari i njësisë bashkiake nr.9 i kërkon partisë më të madhe opozitare në NJQV-në e tij të caktojë personat që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës për çdo QV. Jo më vonë se data 1 shtator 2007 partia duhet të ketë dorëzuar listën e personave që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës;

- Me vendim brenda datës 3 shtator 2007 kryetari i njësisë bashkiake nr.9, bën caktimin e

grupeve dyshe të punës për njoftimin e zgjedhësve për çdo qendër votimi. Njoftimi mund të kryhet edhe vetëm nga përfaqësuesi i administratës së NJQV-së nëse partia politike nuk respekton afatet e caktuara në këtë udhëzim, kur ajo është njoftuar me shkrim nga kryetari;

- Zyrat e gjendjes civile vënë në dispozicion të çdo grupi njoftimi, brenda datës 3 shtator, njoftimet përkatëse dhe listën përfundimtare të zgjedhësve të QV-së përkatëse;

- Grupet e punës kryejnë njoftimin për çdo familje që ndodhet në listën përfundimtare të zgjedhësve të qendrës së votimit brenda datës 13 shtator 2007. Kryefamiljari ose një person madhor i familjes firmos në listën e zgjedhësve kur merr njoftimin.

8. Ndryshimet në lista pas shpalljes së listës përfundimtare bëhen në përputhje me nenin 60 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

9. Kryetari i njësisë bashkiake nr.9, vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ kopje të listës përfundimtare të zgjedhësve, jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës dhe pa pagesë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vë në dispozicion të subjekteve zgjedhore të regjistruara në KQZ kopje të listës përfundimtare të zgjedhësve për zonën zgjedhore, jo më vonë se tre ditë nga data e paraqitjes së kërkesës dhe pa pagesë.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.46, datë 10.8.2007

PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË GJOBAVE DHE TË LLOGARITJES SË DËMIT QË DO TË APLIKOHEN NDAJ KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 46/1 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2007, pasi shqyrtoi draftin mbi tabelën e gjobave, si dhe atë të dëmit ekonomik, që do të aplikohen ndaj klientëve që gjenden me kundërvajtje administrative në përdorimin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Të miratojë tabelën e llogaritjes së gjobave, si dhe atë të llogaritjes së dëmit ekonomik, të detajuara sipas rastit të kundërvajtjes administrative të parashikuara në nenin 46/1 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Konstatimi i masave administrative të bëhet konform ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

TABELA E VLERËS SË GJOBËS

Kundërvajtja administrative	Vlera e gjobës (lekë)
PËR LIDHJE ABUZIVE PARA SISTEMIT MATËS	
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “a”	
Banesë me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A	1 000
Banesë me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	lekë 3 000
Banesë me lidhje 3/ fazore	lekë 5 000
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “a”	
	10 000
	lekë 20 000
Me lidhje në TU	lekë 30 000
Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)	lekë 40 000
Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	lekë 40 000
Me lidhje 3/fazore deri 50kw ose automat deri 80 (përfshirë)	lekë 50 000
Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	lekë 70 000
Me lidhje në TM ose TL	lekë 90 000
Me kabinë vetjake deri 100 KVA (përfshirë)	lekë 100 000
Me kabinë vetjake mbi 100 - 400 KVA (përfshirë)	lekë 70 000
Me kabinë vetjake mbi 400-1000 KVA (përfshirë)	lekë 90 000
Me kabinë vetjake mbi 1000 KVA	lekë 100 000
PËR CENIM TË SISTEMIT MATËS DHE VULAVE TË TIJ	
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “b”	
Banesë me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)	1 000
Banesë me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	5 000
Banesë me lidhje 3/ fazore	10 000
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “b”	
Me lidhje në TU	10 000
Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)	lekë 30 000
Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	lekë 60 000
Me lidhje 3/fazore deri 50kw ose automat deri 80 (përfshirë)	lekë 80 000
Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	lekë 100 000
Me lidhje në TM ose TL	lekë 200 000
Me kabinë vetjake deri 100 KVA (përfshirë)	lekë 250 000
Me kabinë vetjake mbi 100 - 400 KVA (përfshirë)	lekë 100 000
Me kabinë vetjake mbi 400-1000 KVA (përfshirë)	lekë 200 000
Me kabinë vetjake mbi 1000 KVA	lekë 250 000

	300 000 lekë
PËR LIDHJE NË RRJETIN ELEKTRIK PA KONTRATË	
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “c”	
Banesë me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)	5 000
Banesë me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	lekë
Banesë me lidhje 3/ fazore	10 000
	lekë
	20 000
	lekë
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “c”	
Me lidhje në TU	100 000
	lekë
Me lidhje në TM ose TL	
Me kabinë vetjake deri 100 KVA (përfshirë)	
Me kabinë vetjake mbi 100 - 400 KVA (përfshirë)	200
Me kabinë vetjake mbi 400-1000 KVA (përfshirë)	000 lekë
Me kabinë vetjake mbi 1000 KVA	300 000
	lekë
	400 000
	lekë
	500 000
	lekë
PËR SHITESË TË FUQISË MBI ATË TË DEKLARUAR NË KONTRATË, neni 41/1 pika 2 germa “d”	
Për përdoruesin jofamiljarë	
Me lidhje në TU	
Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)	5
Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë	000 lekë
Me lidhje 3/fazore nga 50kw ose automat deri 80 A (përfshirë)	10
Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	000 lekë
Me lidhje në TM ose TL	15
Me kabinë vetjake deri 100 KVA (përfshirë)	000 lekë
Me kabinë vetjake mbi 100 - 400 KVA (përfshirë)	20
Me kabinë vetjake mbi 400-1000 KVA (përfshirë)	000 lekë
Me kabinë vetjake mbi 1000 KVA	
	20
	000 lekë
	30
	000 lekë
	40
	000 lekë

	50 000 lekë
LIDHJE ABUZIVE PARA SISTEMIT MATËS Klasifikohen rastet kur abonenti ka kontratë për furnizimin me energji, ka sistem matës të energjisë (aktive, reaktive) me të gjitha elementet e sigurisë (vulosja) të rregullta dhe konstatohet me lidhje (linjë) të instalimeve elektrike të përdoruesit para sistemit matës të energjisë.	
CENIM I SISTEMIT MATËS DHE VULAVE TË TIJ Klasifikohen rastet kur abonenti ka kontratë për furnizimin me energji elektrike dhe sistem matës të energjisë (aktive, reaktive) të dokumentuar në kontratën e furnizimit me energji elektrike të lidhur me furnizuesin, por të cenuar pajisjet matëse (qoftë edhe njëra nga tërësia), cenuar skema e matjes së bashku me lidhjet e nevojshme kabllore dhe elementet e sigurisë (vulosja) së sistemit matës.	
LIDHJE NË RRJETIN ELEKTRIK PA KONTRATË Klasifikohen rastet kur instalimet elektrike të përdoruesit konstatohen të lidhura në rrjetin elektrik të furnizuesit, pa lidhur kontratë furnizimi (definitive) me energji elektrike.	
Kur përdoruesi konstatohet njëkohësisht me “lidhje abuzive para matësit” dhe “cenim të sistemit matës dhe të e vulave të tij”, ndaj kundërvajtësit aplikohet gjoka me vlerë më të madhe dhe llogaritet vetëm një dëm.	
Për rastet kur sistemi i matjes ndodhet në bokse kolektive dhe konstatohen cenime të tij, enti shpërndarës të hetojë veprimin për të përcaktuar kundërvajtësin.	

TABELA E LLOGARITJES SË DËMIT

Sipas kundravajtjes administrative	Llogaritja e dëmit (kwh, kvArh,)
PËR LIDHJE ABUZIVE PARA SISTEMIT MATËS	
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “a”	
Banesë me lidhje 1/fazore	2 000 kwh
Banesë me lidhje 3/ fazore	3 000 kwh
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “b”	

kwh	Me lidhje në TU		
	Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)		3 000 kwh
	Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë		6 000 kwh
	Me lidhje 3/fazore deri 50kw ose automat deri 80 A (përfshirë)		10 000
kwh	Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	energji aktive	15 000
		energji reaktive	6 000 kvArh
	Me lidhje në TM ose TL		
	Me kabinë elektrike vetjake	energji aktive	($S_{TFV} \times 500$) kwh
		energji reaktive	($S_{TFV} \times 200$) kvArh
PËR CENIM TË SISTEMIT MATËS DHE VULAVE TË TIJ			
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “b”			
	Banesë me lidhje 1/fazore		2 000 kwh
	Banesë me lidhje 3/ fazore		3 000 kwh
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “b”			
kwh	Me lidhje në TU		
	Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)		3 000 kwh
	Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë		6 000 kwh
	Me lidhje 3/fazore deri 50kw ose automat deri 80 A		10 000 kwh
	Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	energji aktive	15 000
		energji reaktive	6 000 kvArh
	Me lidhje në TM ose TL		
	Me kabinë elektrike vetjake	energji aktive	($S_{TFV} \times 500$) kwh
		energji reaktive	($S_{TFV} \times 200$) kvArh
PËR LIDHJE NË RRJETIN ELEKTRIK PA KONTRATË			
Për përdoruesin familjarë, neni 46/1 pika 1 germa “c”			
	Banesë me lidhje 1/fazore		3 000 kwh
	Banesë me lidhje 3/fazore		4 000 kwh
Për përdoruesin jofamiljarë, neni 46/1 pika 2 germa “c”			
kwh	Me lidhje në TU		
	Me lidhje 1/fazore me automat deri 16 A (përfshirë)		6 000 kwh
	Me lidhje 1/fazore me automat 20 A e lartë		12 000 kwh
	Me lidhje 3/fazore deri 50kw ose automat deri 80 A		20 000
kwh	Me lidhje 3/fazore mbi 50kw ose automat mbi 80 A	energji aktive	30 000
		energji reaktive	12000 kvArh
	Me lidhje në TM ose TL		
	Me kabinë elektrike vetjake	energji aktive	($S_{TFV} \times 1000$) kwh
		energji reaktive	($S_{TFV} \times 400$) kvArh
LIDHJE ABUZIVE PARA SISTEMIT MATËS			
Klasifikohen rastet kur abonenti ka kontratë për furnizimin me energji, ka sistem matës të energjisë (aktive, reaktive) me të gjitha elementet e sigurisë (vulosja) të rregullta dhe konstatohet me lidhje (linjë) të instalimeve elektrike të përdoruesit para sistemit matës të energjisë.			

CENIM I SISTEMIT MATËS DHE VULAVE TË TIJ Klasifikohen rastet kur abonenti ka kontratë për furnizimin me energji elektrike dhe sistem matës të energjisë (aktive, reaktive) të dokumentuar në kontratën e furnizimit me energji elektrike të lidhur me furnizuesin, por të cenuar pajisjet matëse (qoftë edhe njëra nga tërësia), cenuar skema e matjes së bashku me lidhjet e nevojshme kablllore dhe elementet e sigurisë (vulosja) të sistemit matës.
LIDHJE NË RRJETIN ELEKTRIK PA KONTRATË Klasifikohen rastet kur instalimet elektrike të përdoruesit konstatohen të lidhura në rrjetin elektrik të furnizuesit, pa lidhur kontratë furnizimi (definitive) me energji elektrike.
Kur përdoruesi konstatohet njëkohësisht me “lidhje abuzive para matësit” dhe “cenim të sistemit matës dhe të e vulave të tij”, ndaj kundërvajtësit aplikohet gjoba me vlerë më të madhe dhe llogaritet vetëm një dëm.
Për rastet kur sistemi i matjes ndodhet në bokse kolektive dhe konstatohen cenime të tij, enti shpërndarës të hetojë veprimin për të përcaktuar kundërvajtësin.
* S_{TFV} tregon fuqinë e transformatorit të vendosur në objekt

VENDIM
Nr.48, datë 14.8.2007

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË INTERKOMPENSIMIT TË TRANSITIMIT”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, pikës 2 të “Modelit transitor të tregut të energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.539, datë 12.8.2004, si dhe nenit 11 pika "c" “Rregullat e tregut të energjisë elektrike” miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.1, datë 25.1.2005. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.8.2007, pasi shqyrtoi marrëveshjen e interkompensimit të transitimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së interkompensimit të transitimit për periudhën qershor-dhjetor 2007.
2. Ngarkohet OST sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike Vlorë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP për truall”, duhet të paraqesin brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit për publikim, vërtetim nga ZRPP për regjistrimin apo futjen në proces regjistrimi të truallit për të cilin pretendon pronësinë, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në të kundërt ky truall do të përjashtohet nga shpronësimi.

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP për objekt”, duhet të paraqesin brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit për publikim, vërtetimin nga ZRPP për regjistrimin apo futjen në proces regjistrimi të objektit për të cilin pretendon pronësinë, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në të kundërt ky objekt do të përjashtohet nga shpronësimi.

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “i pakonfirmuar ose të pakonfirmuar”, duhet të paraqesin brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit për publikim, vërtetim nga ZRPP për regjistrimin apo futjen në proces regjistrimi të pasurive për të cilin pretendon pronësinë, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në të kundërt këta pronar do të përjashtohen nga shpronësimi.

Të gjithë pronarët e përmendur në tre paragrafët e mësipërm, do të kompensohen për efekt shpronësimi nëse vërtetojnë titullin e pronësisë sikurse u shprehëm më sipër, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 73 695 339.6 (shtatëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Rrethi Vlore

Bashkia Vlore

Lista e Pronareve qe shpronsohen per efekt te ndertimit te rruges Transballkanike.

Lloji I Pasurise Patundshme: Truall dhe objekte nr.(1-49)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr.Parc	Z.Kadastrale	TRUALL			Objekte			Vlera totale ne leke	Sherime
						Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefte ne leke	Sip. (m2)	Cmimi L/m2	Vlefte ne leke		
1	Lefter		Lamce	4/210	8604	670	1729	1158430				1158430	Konflikt gjyqësor
2	Gezim		Shaqiraj	18/38, 18/132	8604	638	1729	1103102	77	1953	150381	1253483	Konfirmim nga ZRRPP
3	Trashëgimtare		Golemi	29/57	8603	79	3102	245058				245058	Konfirmim nga ZRRPP
4	Nuri		Stefani	20/93	8603	116	3102	359832	62.2	42000	2612400	2972232	Konfirmim nga ZRRPP
5	Spiro		Dino	18/109, 18/114	8604	537	1729	928473	108.4	1953	211705.2	1140178.2	Konfirmim nga ZRRPP vetëm për truall
6	Kamber		Karpuri										
7	Aferdita		Dervishaj	29/49	8604	60	1729	103740	98	1953	191394	295134	Konfirmim nga ZRRPP
8	Bardhyl		Lilaj	39/54	8605	45	4475	201375				201375	Konfirmim nga ZRRPP
9	Guri		Kamberi	29/383	8603	150	3102	465300	68	42000	2856000	3321300	Konfirmim nga ZRRPP
10	Lavderim		Muka		8605				132	1900	250800	250800	Konfirmim nga ZRRPP
11	Llambi		Mitre	29/33	8605	176	4475	787600				787600	Konfirmim nga ZRRPP
12	Soltraq		Mitre	29/34	8605	330	4475	1476750				1476750	Konfirmim nga ZRRPP
13	Haxhi		Alliraj	5/46	8604				80	1953	156240	156240	Konfirmim nga ZRRPP
14	Astrit		Alimerko		8604				50	1953	97650	97650	Konfirmim nga ZRRPP
15	Taip		Feta	29/386	8603	80	3102	248160				248160	Konfirmim nga ZRRPP
16	Agim	Vesel	Arifi	24/149	8603	80	3102	248160				248160	Konfirmim nga ZRRPP
17	Trashëgimtare		Muco	35/82	8604	532	1729	919828	189	1953	369117	1288945	Të pakonfirmuar
18	Faim		Rizaj	4/125	8604	50	1729	86450	50	1953	97650	184100	Konfirmim nga ZRRPP
19	Engjell		Sadriaj	35/78	8604	365	1729	631085	68	1953	132804	763889	Konfirmim nga ZRRPP për objekt
20	Shaqir		Koburja	39/15	8605	22	4475	98450	22	1900	41800	140250	Konfirmim nga ZRRPP
21	Shaze		Lazaj	18/130	8604	143	1729	247247				247247	Konfirmim nga ZRRPP
22	Agron		Haxhiraj		8605	938	4475	4197550				4197550	Konfirmim nga ZRRPP

22	Xhyher	Xhyheri	45/222.50/23	8605	350	4475	1566250					1566250	Konfirmim nga ZRRPP
23	Flora	Cekodhina	5/46	8604	51	1729	88179	31	1953	60543	148722	Konfirmim nga ZRRPP për objekt	
24	Lili	Goleni	121	8604	63	1729	108927				108927	E pakonfirmuar	
25	Trashëgimtarët	Skendaj	18/3	8603	204	3102	632808	290	42000	12180000	12812808	Konfirmim nga ZRRPP	
26	Piro	Kondi		8605				22	1900	41800	41800	Të pakonfirmuar	
27	Ahmet	Sjerifaj		8605				20	1900	38000	38000	I pakonfirmuar	
28	Malo	Resulaj	29/418	8603	45	3102	139590	240	42000	10080000	10219590	Konfirmim nga ZRRPP për truall	
29	Theofan	Meci		8603	154	3102	477708	234	42000	9828000	10305708	I pakonfirmuar	
30	Filip	Meci		8603	154	3102	477708	36	42000	1512000	1989708	I pakonfirmuar	
31	Zija	Ciftiu	4/77	8604	319	1729	551551	54	1953	105462	657013	Konfirmim nga ZRRPP për truall	
32	Jorgji	Vidhaj	4/120	8604	193	1729	333697	91	1953	177723	511420	Konfirmim nga ZRRPP	
33	Artan	Zemani		8604	213	1729	368277	105	1953	205065	573342	Konfirmim nga ZRRPP për truall	
34	Qemal	Tringa		8604	300	1729	518700				518700	I pakonfirmuar	
35	Idai	Shehu	2575	8605	312	4475	1396200	91.3	1900	173470	1569670	I pakonfirmuar	
36	Vasil	Leka	30/56	8605	180	4475	805500	142	1900	269800	1075300	Konfirmim nga ZRRPP	
37	Bashkim	Rodha	36/36	8605	165	4475	738375	41	1900	77900	816275	Konfirmim nga ZRRPP për objekt	
38	Sulejman	Tahiri		8604	42	1729	72618				72618	I pakonfirmuar	
	Agim												
	Ylli												
	Luiza												
39	Dilaver	Kalemaj		8603	161	3102	499422	74.6	42000	3133200	3632622	Konfirmim nga ZRRPP për truall	
40	Sotir	Bezhani	5/2	8604	389	1729	672581	98	1953	191394	863975	Konfirmim nga ZRRPP	
41	Bajram	Saliu	27/200	8604	515	1729	890435	108.8	1953	212486.4	1102921.4	Konfirmim nga ZRRPP për truall	
42	Veiz	Shahu	4/122	8604	280	1729	484120	77	1953	150381	634501	Konfirmim nga ZRRPP	
43	Kristaq	Komini		8605	84	4475	375900				375900	I pakonfirmuar	
44	Evis	Shehi	18/50	8604	495	1729	855855				855855	Konfirmim nga ZRRPP	
45	Hekuran	Allaj	20/115	8603	16.5	3102	51183	59	42000	2478000	2529183	Konfirmim nga ZRRPP	
	Shuma				9696.5		25612174	2819.3		48083165.6	73695339.6		

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.367, datë 11.7.2007, shpall të vdekur shtetasin Zenel Zabit Kaferi, i datëlindjes 19.5.1967, me datë vdekjeje 9.3.1996.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 15.8.2007
Doli nga shtypi më 15.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë